

BREAKING NEWS

x

MBI 2 MIJE TESTIME! ZBARDHEN TE DHENAT E FUNDIT, JA SA RASTE TE REJA ME CO...

AKTUALITET

Ngjarje e rëndë në Korçë/ Një person tenton të vrasë me armë zjarri policët (DETAJE+EMRI)

SHKRUAR NGA SOT.COM.AL
6 SHKURT 2019

Facebook

WhatsApp

Twitter

Email



Policia e Korçës ka parandaluar një ngjarje që mund të kishte pasoja fatale.

Arrestohet në flagrancë një shtetas i cili tentoi të vrasë me armë zjarri punonjësit e Policisë së Shtetit, të cilët ndërhyjnë për të neutralizuar konfliktin e këtij shtetasi, me një shtetas tjetër.

Ditën e sotme është marrë një telefonatë ku është kërkuar ndihma e Policisë në lagjen nr 4 në Korçë, pasi një shtetas në gjendje të dehur po konfliktohej me një shtetas tjetër, duke sjellë shqetësim tek banorët.

Menjëherë janë dërguar shërbimet e Policisë drejt adresës së dhënë, ku nga verifikimet ka rezultuar se shtetasi G.Xh, 69 vjeç, në gjendje të dehur, ishte konfliktuar për motive të dobëta me shtetasin A.H, 47 vjeç, të dy banues në këtë lagje duke u bërë shqetësim për banorët, ku shtetasi Gani Xhambazi ishte larguar menjëherë për në banesë ku dyshohet se do merrte një armë zjarri.

Në momentin që shërbimet e Komisarariatit Korçë janë drejtuar për tek banesa e tij, 69 vjeçari u ka drejtuar armën e zjarrit automatik, duke tentuar të qëllonte në drejtim të punonjësve të policisë por fatmirësisht arma u bllokua duke mos realizuar qitjen.

Policia ka neutralizuar autorin duke bërë arrestimin e tij në flagrancë për veprat penale “Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit, mbetur në tentativë” dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve dhe i municionit”. Shtetasi i lartpërmendur, rezulton i dënuar më parë për veprat penale “Vjedhja” dhe “Dhuna në familje”.

Në cilësinë e provës materiale u sekuestrua një armë zjarri automatik dhe 88 copë fishekë luftarakë, të cilat i posedonte pa leje.

YOU MAY LIKE

by **mgid**

Učitelj iz Beograd postao
milijoner što je saznao za ovu
metodu